



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 38, datë 31.03.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES  
PËR REGJISTRIMIN E AGJENTIT TË SHITJES SË SIPËRMARRJEVE TË  
INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME PJESËMARRJE TË HAPUR ME OFERTË  
PUBLIKE NË TITUJ TË TRANSFERUESHËM TË MIRATUARA NË NJË VEND  
ANËTAR TË BE-së**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e rregullores “Për regjistrimin e agjentit të shitjes së sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshëm të miratuara në një vend anëtar të BE-së”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**